VENDIM
Nr. 43, datë 6.3.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ALBGAZ" SHA, PËR SHTYRJE TË AFATIT TË VENDIMMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE-s

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; 53, pikat 1 dhe 3, nenit 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 24, pika 1, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 37/2 prot., datë 26.2.2020, mbi kërkesën e shoqërisë "Albgaz" sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 32/55 prot., datë 25.11.2019, ka kryer njoftimin në medien e shkruar, si dhe me shkresën nr. 729/1 prot., datë 3.12.2019, ka përcjellë pranë subjektit "Albgaz" sh.a., njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit të konstatuar në dosjen e aplikimit.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 84 prot., datë 16.1.2019, ERE i është drejtuar sërish shoqërisë me një kujtesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 288 prot., datë 28.1.2020, ka paraqitur pjesërisht dokumentacionin lidhur me plotësimin e kërkuar dhe plotësimi konsiston në vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, me nr. T01704822, datë 14.1.2020, nga i cili rezulton se shoqëria nuk ka detyrim tatimor të papaguar deri në datën e lëshimit të vërtetimit. Për këtë arsye, ERE iu drejtua sërish shoqërisë "Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 288/1 prot., datë 4.2.2020, duke i rikërkuar plotësimin sipas kërkesave të rregullores të dokumentacionit të mbetur.

- Në vijim, shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 288/2 prot., datë 8.2.2020, ka përcjellë në ERE kërkesën për shtyrje të vendimmarrjes finale të Bordit, në pamundësi për t'i plotësuar këto dokumente brenda afateve dhe ka deklaruar se një pjesë e tyre është në proces përpilimi.

- Neni 24 i rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s parashikon se: Nëse një person paraqet një kërkesë të ndryshme nga sa parashikohet në këto rregulla, atëherë ERE do të procedojë në përputhje me dispozitat që rregullojnë atë çështje sipas legjislacionit në fuqi.

- Në zbatim të nenit 53, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim "afatet procedurale", përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.

- Afati i parashikuar në rregulloren e licencimit për marrjen e vendimit përfundimtar të Bordit të ERE për miratimin apo refuzimin e kërkesës është 60 ditë.

- Në zbatim të nenit 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

- Në zbatim të nenit 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

"1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar, sipas nenit 91 të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.".

Kërkuesi, ka paraqitur një kërkesë të arsyetuar, përpara përmbushjes së afateve të parashikuara për mbylljen e kësaj procedure në datën 3.3.2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë "Albgaz" sh.a. për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 1.7.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Petrit Ahmeti